

Raport teknik – projektideja e sistemimeve përreth ndërtesës dhe plotësime e përmirësimi i kushteve të saj

“Rehabilitimi i ISTN (Instituti i studimeve teknologjike të ndërtimit- Tiranë, Betahaus-Tirana.
Rruga: "Muhamet Gjollësia".

Hartoi:
UTS-01. shpk



Tetor 2020

Përmbajtja

1. Hyrje.....	5
2. Objekti	6
3. Identifikimi i realizimit të projektit në punimet e zbatimit	7
3.1 Identifikimi i punimeve të pakryera	7
3.2 Identifikimi i punimeve të zbatimit	8
4. Punime rinovimi për ndërtesën.....	10
4.1 Plotësimin dhe përmirësimin e zërave të parashikuara në projektin fillestar.....	10
4.2 Zëra shtesë të domosdoshëm të paparashikuara në projektin fillestar	11
4.3 Përtëritja/rehabilitimi i ndërtesës së arkivës	15
4.4 Sistemi HVAC	15
4.5 Sistemet elektrike.....	17
4.6 Ashensori.....	17
5. Sistemimet përreth ndërtesës dhe zona e parkimit.....	18
6. Hapat për hartimin e projekt-zbatimit dhe kryerjen e punimeve.....	19
7. Përvoja e zbatuesit	19

1. Hyrje

Ky raport teknik hartohet në kuadër të zbatimit të fazës së dytë të projektit: “Rehabilitimi i ISTN (Instituti i studimeve teknologjike të ndërtimit- Tiranë, Betahaus-Tirana”, të hartuar në vitin 2017, për një nga ndërtesat e Institutit, e cila në fillesat e saj shërbente për prova laboratorike të materialeve të ndërtimit dhe ishte pjese e një kompleksi me të gjerë godinash, me karakter industrial. Ndërtesa gjendet në Rrugën: “Muhamet Gjollësja”, menjëherë pas Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe midis kësaj të fundit dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës (Fig. 1).

Ky raport shërbensi plotëues i projektit fillestar dhe duhet të mbahet parasysh gjatë hartimit të projektzbatimit të fazës 2 së bashku me projekt-zbatimin e fazës I.

Projekti për Rehabilitimin e kësaj ndërtese ka pasur si qëllim ripërdorimin e gjithë ndërtesës ekzistuese dhe kthimin e përshtatjen e saj në një ndërtesë polifunksionale të përbërë nga hapësira për “co-working” fleksibël dhe të qëndrueshme, me salla eventesh, zyra biznesesh, kinema, punishte dhe garazhe, kafe letrare, restorant, salla trajnimesh, laboratorë dhe bibliotekë, si edhe hapësira të hapura relaksuese. Projekti ka qenë inovativ dhe ka synuar të sjellë në qytet përvojat ndërkombëtare për të mbështetur qytetarët dhe bizneset që të jenë krijuar dhe inovativë duke punuar në një hapësirë inovative sociale, duke ndarë idetë e tyre, duke ju ofruar trajnime, mbështetje dhe shërbime për zhvillimin e kompetencave në fushën e inovacionit dhe konkurrencës.

Mbi bazën e projektit të hartuar në vitin 2017, raporteve të hartuar për zbatimin e tij, preventivit të situacionuar në ndërtesë dhe atkollaudimit, për vënin në shërbim të ndërtesës, aty janë kryer një pjesë e zërave plotësisht, një pjesë tjetër pjesërisht, sikurse disa prej zërave të caktuar në projektin fillestar nuk janë dhe nuk këndë filluar të zbatohen.

Aktualisht në vitin 2020, përdorimi i kësaj ndërtese është për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në projektin fillestar për rehabilitimin e saj.

Ky fakt sjell domosdoshmërinë e rishikimit të projektit për të kuptuar fillimisht se cilat punime nuk janë kryer. Gjithashtu për punimet e pa kryera, rishikimi i projektit duhet bërë për të kuptuar nëse sot, pra disa vite pasi është hartuar projekti, diçka mund të bëhet më mirë, me teknologjitë e kohës dhe sistemet e reja. Ky proces rishikimi nevojitet edhe për të gjetur përshtatje të mundshme, të punimeve të kryera me ato që do të kryen atje ku ato janë të nevojshme.

Hartimi i projektit për punimet e përmirësimit të kushteve të funksionimit të Betahaus, për përdorimin e ri, do të kryhet në përputhje me nevojat e përdoruesve të hapësirave.



Fig. 1 Pozicionimi i ndërtesës në shqyrtim. *Imazh nga google map.com*

2. Objekti

Objekti i punës është pikërisht ndërtesa e prezantuar më sipër në gjendjen faktike pas ndërhyrjeve rehabilituese të kryera në të.

Ndërhyrja ka patur në vëmendje temën e Arkeologjisë Industriale. Është treguar kujdes i veçantë që të ruhet struktura ekzistuese dhe arketipi i godinës industriale. Struktura e kolonave dhe trarëve të parapërgatitur është ruajtur në dukje në interior.

Pra koncepti i projektimit të rehabilitimit të godinës ka qenë përdorimi i strukturave ekzistuese të saj, dhe elementeve ekzistues në të, siç janë bërë tashmë dy vinçat pjesë e arkitekturës së interiorit edhe eksterierit të saj.

I vetmi modifikim radikal në strukturën e vjetër të ndërtesës, ka ndodhur me mbulesën e saj, e cila ka qenë e tipit me elemente “të valëzuar” të parandëruar. Pas kqyrjes në vend nga ana e grupit projektues dhe konsultimit me konstruktorin e veprës u arrit në konkluzion për zëvendësimin e mbulesës.

Për shkak të kostonë tejet të lartë që ka prodhimi i një strukture të tillë të valëzuar u vendos që mbulesa të jetë përsëri e tipit industrial dhe u vendos të mbulohej me “Shed”. Struktura e lejon realizimin e këtij tipi mbulesë dhe përshtatet totalisht edhe me orientimin e ndërtesës, pra “shed”-et marrin dritë natyrore nga veriu. Fig. 2

Struktura e vjetër e ndërtesës ka pasur një hapësirë të vetme me lartësi rreth 10 metër.

Pikërisht hapësira e brendshme ka pësuar ndryshimin më të madh. Ambienti i brendshëm është zënë me një strukturë të re të ndarë në tre nivele të cilat përdorin si mbështjellë strukturën e vjetër.

Ndërtesa e re me strukturë betoni ka formën drejtkëndore dhe zhvillohet me atrium në mes. Ajo ka tre nivele të cilat lidhen nëpërmjet dy shkallëve. Atriumi kap vetëm 2 nivelet e dyta. Siç u përmend edhe më sipër kjo strukturë u projektua për funksione rekreacioni dhe

bashkëveprimi apo bashkëpunimi midis njerëzve me interesa të përbashkëta , ndërsa në situatën faktike shumica e hapësirave një katëshe përdoret për zyra. Fig. 3

Sallat për shumë përdorime në qendër të ndërtesës faktikisht janë të zbrazëta, por që parashikohen të përdoren përsëri për funksione publike dhe të ruhet karakteri shumë përdorimesh i tyre.

Fasadat e ndërtesës kanë pësuar vetëm rifreskim me suva të re.

Dritaret në situatën faktike janë plastike dhe me xhama dopio.



Fig. 2 Mbulesa e tipit "Shed"




Fig. 3

3. Identifikimi i realizimit të projektit në punimet e zbatimit

3.1 Identifikimi i punimeve të pakryera

Për hartimin e këtij raporti u vu në dispozicion projekti i plotë i hartuar në vitin 2017.

Për të analizuar dhe ballafaquar situatën faktike të nivelit të punimeve të zbatimit u krye dhe vizita e nevojshme në objekt.

Prej këqyrjes paraprake të projektit dhe objektit në vend si dhe pas krahasimit të dokumentave të zbatimit që evidentojnë kryerjen e zërave të punimeve të deritanishëm u evidentua se një pjesë e parashikimeve në projekt nuk janë realizuar ende.

Zërat e pa realizuar nga projekti në zbatim, renditen si më poshtë:

1. Sistemi HVAC në ndërtesë;
2. Sistemi i paneleve fotovoltaike;
3. Mobilimi i brendshëm;
4. Montimi i ashensorit;
5. Sistemimi dhe gjelbërimi i territorit përreth ndërtesës;
6. Sistemimi i parkimit përballë fasadës lindore të objektit; Fig. 4
7. Mobilimi me elemente urbanë dhe ndriçimi i territorit përreth ndërtesës;
8. Prishja e një ndërtese ekzistuese një katëshe në anën veri-lindore të ndërtesës në shqyrtim;
9. Realizimi i parkimit publik në anën veriore të ndërtesës;
10. Realizimi i rrugës po në anën veriore të ndërtesës e cila çan përtej kuartallin;
11. Lyerja e vinçit të jashtëm në fasadën perëndimore të ndërtesës dhe pajisja e saj me urë kalimi sipas projektit; Fig. 5
12. Rehabilitimi dhe lartësimi me kat shtesë i ndërtesës njëkatëshe lineare në anën perëndimore të ndërtesës në shqyrtim.



Fig. 4 Parkimi përballë fasadës lindore



Fig. 5 Vinçi në fasadën perëndimore

3.2 Identifikimi i punimeve të zbatimit

Nga vizita në vend, u krye vëzhgimi i hollësishëm në elementët ndërtimorë, në ata arkitektonikë dhe teknikë e të instalimeve. Kryesisht u vëzhguan teknikat, materialet dhe mënyrat e ndërtimit të elementeve arkitektonikë.

Theksohet këtu se ndërtesa ka ndryshuar funksionin. Pra ajo po përdoret për qëllim të ndryshëm nga ai i projektimit. Nëse sipas projektit fillestar, ndërtesa ka qenë e projektuar për të funksionuar në përgjithësi si “open space”, hapësirat e saj tani po përshtaten për zyra. Që nga qasja e parë me ndërtesën, u vu re se kjo përshtatje do të jetë më impenjative se sa përshtatja e hapësirave standarde në zyra administrative.

Nga ballafaqimi i situatës faktike të realizimit të punimeve të zbatimit të vëzhguar me sy të lirë, me të supozuarën; “ndërtesën BetaHouse etalon” e cila do të plotësonte të gjitha komoditetet e nevojshme për zyra, u vunë re, tre probleme, si më poshtë, të cilat duhet të trajtohen në fazën e dytë:

1. **Mungesa e termoizolimit, kudo në mbështjellën (zarfin) e ndërtesës.** Meqë ky element nuk ishte parashikuar në projekt, mbetet e kuptueshme që as nuk është zbatuar. Në Fig. 6 tregohet me foto detaji i dëmtimit të suvasë së jashtme, pas të cilës perceptohet tulla dhe jo shtresë termoizolimi. Prej trashësisë së mureve në çarjet e dyerve dhe dritareve në mbështjellën e ndërtesës (rreth 25 cm) kuptohet që nuk ka shtresë termoizoluese, sepse në rast të kundërt trashësia e mbështjellës do të ishte më e madhe;
2. **Sipërfaqe e madhe e xhamarive në fasadën perëndimore, Fig. 7;**
3. **Asnjë nga dritaret në fasada nuk mundëson ajrimin natyral** (pra nuk kanë kanata me mundësinë e hapjes). Ky fakt, ishte i parashikuar në projekt. Përveç dyerve si pjesë e xhamarive asnjë pjesë tjetër e tyre nuk është parashikuar dhe është zbatuar pa kanata të hapshme.

Kombinimi i të tre gjendjeve faktike të mësipërme në ndërtesë dhe mungesa e impiantit HVAC, sjell në kushtet e periudhës së nxehtë të vitit, temperatura të brendshme që i kalojnë 45°C, sepse hapësira në katet e sipërme, është në kushtet e mungesës së të paktën ventilimit natyral. Xhamaria në anën perëndimore luan rolin e kapjes së energjisë diellore shtesë dhe njëkohësisht krijon efektin “serë”.

Në kushtet e efektit “serë” në periudhën e nxehtë të vitit çdo sistem HVAC që do të instalohet në ndërtesë do të ishte i mbi dimensionuar dhe jo eficient. Në ditët me temperatura ekstreme gjatë vitit efekti i punës së çdo sistemi mund të ishte minimal ose i pandjeshëm. Në ditët e nxehta të verës, tejnxehja e hapësirave të brendshme do vinte prej rrezatimit diellor me orë të zgjatura në fasadën perëndimore. Harxhimet e energjisë për ftohje, por edhe për ngrohje në kushtet e dimrit dhe mungesës së termoizolimit, do të ishin shumë herë më të mëdha se sa në rast se ndërtesa do të ishte e termoizoluar. Humbjet e energjisë janë të mëdha.



Fig. 6 Detaj i dëmtimit të suvasë



Fig. 7 Fasada perëndimore

Vetëm nëse merren për referencë: Ligji Nr. 124/2015, PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË dhe Ligji Nr. 116/2016 PËR PERFORMANCËN E ENERGJISË SË NDËRTESAVE, kuptohet se për të arritur eficientë rruga kalon nga reduktimi i humbjeve të energjisë. Për të arritur performancë të mirë energjetike për të gjithë ndërtesën dhe reduktuar humbjet, nevojitet termoizolimi i të gjithë ndërtesës.

Nga vizita në vend, me sy të lirë u vu re se as tarracat “shed”, nuk janë të termoizoluara. Në periudhën e nxehtë të vitit nën rrezatimin diellor përgjithësisht sipërfaqet e tarracave, fitojnë temperatura 70°C deri 80°C. Në mungesë të termoizolimit nën efektin e përcjellshmërisë dhe konveksionit një pjesë e madhe e nxehtësisë së fituar nga tarraca përcillet në hapësirën poshtë saj. Kjo është edhe një nga arsyet që temperatura në ajrin e brendshëm në katin e sipërm të hapësirës shkon mbi 45°C.

Meqë betoni ka përcjellshmëri të lartë termike, pra më të lartë edhe krahasuar me drurin, atëherë çdo kW energji shtesë që do të harxhohet për ngrohjen e hapësirave të zyrave në kushtet e periudhës së ftohtë të vitit, do të humbasë më shpejt prej tarracës së pa termoizoluar, sepse natyrisht ajri i ngrohur, meqë është më i lehtë tenton drejt kuotave më të larta të hapësirës dhe ushtron presion në kufizuesin e sipërm.

Gjithashtu, një detaj i rëndësishëm që u vu re në punimet e zbatimit, ishte pasaktësia e kryer në kapjen e kuotave të sistemit të jashtëm përkundrejt kuotave të dyshemesë të katit përdhe të ndërtesës. Kjo e fundit qëndron më poshtë se kuota e trotuarit të sistemit të jashtëm në fasadën lindore. Pasoja e kësaj pasaktësie vërtetohet nga përdoruesit aktualë të ndërtesës, të cilët pohuan se gjatë periudhës së reshjeve, uji i shiut depërton në ndërtesë prej pragjeve të dyerve në fasadë. Ky është një fakt që në vazhdim mund të sjellë probleme të rënda të lagështirës në brendi të ndërtesës por edhe dëmtime të rifiniturave, përkeqësim të muraturës së tullës dhe probleme të mykut e dëmtim të mobiljeve. Riparimi këtij defekti

do të jetë i detyrueshëm dhe i pashmangshëm në këtë fazë të punimeve para se gjendja e rifiniturave të përkeqësohet dhe të nevojiten ndërhyrje më të mëdha.

4. Punime rinovimi për ndërtesën

Në bazë të sa u thanë mësipër, për të përmbushur kushtet edhe për të kthyer ndërtesën në funksion të përdorimit aktual, ky raport nxjerrë në pah domosdoshëminë e kryerjes së zëpunimeve vijuese:

4.1 Plotësimin dhe përmirësimin e zërave të parashikuara në projektin fillestar

Të kryhen apo të plotësohen të gjitha punimet e zbatimit të pa kryera të parashikuara në projektin e hartuar në vitin 2017 “Rër rehabilitimin e ndërtesës në fjalë si pjesë e ISTN” , të gjitha të renditura në paragrafin 3.1 të këtij raporti-projektide dhe të propozuara në preventivin përkatës.

- a. Rishikimi i projekt-zbatimit mekanik dhe elektrik për projektimin dhe instalimin e sistemit HVAC në ndërtesë;
- b. Të analizohet efektshmëria, bilanci i shpenzimeve kundrejt përfitimit në kohë dhe analiza e kthimit të investimit për implementimin e sistemit të paneleve fotovoltaike (të parashikuara të paktën sipas projektit arkitektonik).;
- c. Të parashikohet dhe projektohet sistemi i paneleve fotovoltaike (të përmendur të paktën sipas projektit arkitektonik). Ky sistem duhet të integrohet me atë elektrik të ndërtesës. Pra të parashikohen edhe ndërhyrjet dhe modifikimet e mundshme në sistemin elektrik ekzistues;
- d. Të plotësohet mobilimi i brendshëm, me referencë projektin fillestar, duke bërë edhe përshtatjet e nevojshme për funksionimin aktual të ndërtesës;
- e. Të montohet ashensori;
- f. Të kryhet sistemimi dhe gjelbërimi i territorit përreth ndërtesës bazuar në projekt-idenë e paraqitur. Të sistemohet parkimi përballë fasadës lindore të objektit. Të mobilohet me elemente urbanë dhe ndriçim i territorit përreth ndërtesës.
- g. Të realizohet infrastruktura nëntokësore (kanalizimet e ujërave të shiut, kanalizimet e ujërave të ndotura, rrjeti furnizimit me ujë nëse shihet e nevojshme gjatë punimeve të zbatimit). Të realizohet sistemi i ujitjes dhe kullimit (drenazhimit) të zonave të gjelbëruara;
- h. Të realizohet shembja e ndërtesës ekzistuese një katëshe në anën verilindore të ndërtesës në shqyrtim;
- i. Të realizohet parkimi publik në anën veriore të ndërtesës;
- j. Lyerja e viçit të jashtëm në fasadën perëndimore të ndërtesës dhe pajisja e saj me urë kalimi sipas projektit;
- k. Rehabilitimi dhe lartësimi me kat shtesë (nëse është i domosdoshëm) i ndërtesës njëkatëshe lineare në anën perëndimore të ndërtesës në shqyrtim, e cila aktualisht shërben pjesërisht si arkivë.

4.2 Zëra shtesë të domosdoshëm të paparashikuara në projektin fillestar

Të kryhen punime plotësuese dhe korrigjime, për të kthyer ndërtesën në kushtet e komoditetit mjedisor në përputhje me funksionin faktik të ndërtesës, për ta kthyer në ndërtesë eficiente, por edhe në auto-eficiente.

- a. Të realizohet në mënyrë të menjëhershme **termoizolimi i të pesë fasadave** të ndërtesës (fasadat dhe tarracat). Nëse do të parashikohet të përdoret fasadë qeramike e ventiluar, kjo mund të përshtatet mirë vetëm në një pjesë të fasadës, por jo në fasadat lindore dhe perëndimore, ku fillon mbulesa e tipit “shed”. Kjo mund të aplikohet lehtësisht në fasadën e pjesës dy-katëshe të ndërtesës me tarracë të sheshtë. Gjithsesi kjo zgjedhje mbetet opsionale, nëse kërkohet fasadë e trajtuar me materiale më rezistente në kohë të cilat njëkohësisht përmirësojnë estetikën e fasadave dhe njëkohësisht imazhin e eksterierit të institucionit. E rëndësishme është zgjidhja e termoizolimit. “Kapotimi” me polisterol i gjithë ndërtesës nga jashtë është dhe suvatimi me suva grafiato është zgjidhja më ekonomike dhe më e thjeshtë për tu realizuar në këtë rast. Aplikimi i termoizolimit nga ana e brendshme e mbështjellës do të sillte fshehjen e fasadave të brendshme dhe shmangien nga ideja e projektuesve, për memorien e funksionit fillestar të ndërtesës të shprehur nëpërmjet arkitekturës industriale.

Ndonëse në projekt-zbatim aplikimi i termoizolimit nuk është parashikuar, ai gjendet si zë në preventivin përkatës me sipërfaqe 448 m². Kjo sipërfaqe gjendet edhe e situacionuar (preventiv i ripunuar gjatë zbatimit) dhe duhet të verifikohet se ku është aplikuar si shtresë termoizoluese, për të mos bërë përsëritje në zërat e punëve për tu kryer.

Në këtë rast grupi projektues rekomandon aplikimin e sistemit “kapotë” për termoizolim me përdorimin e polisterolit me koeficient të përcjellshmërisë termike jo më të madhe se $\lambda=0.035 \text{ W/mK}$, të aplikuar me trashësi jo më të vogël se 80 mm në fasada vertikale dhe me trashësi jo më të vogël se 200 mm në total për tarracën e sheshtë dhe mbulesën “shed”. Detyrimisht të termoizolohen të gjitha paturat dhe arkitrarët e çarjeve me polisterol 10mm deri 20 mm trashësi sipas gjerësisë së kasave të dritareve ekzistuese. Termoizolimi duhet të përplasat me kasat. Gjithashtu, të thyhen apo të priten të paktën pikoret e të gjithë davancalëve të dritareve, për të realizuar kapotimin total të kasave të dritareve. Davancalët e rinj rekomandohet të jenë llamarinë e zinguar e të lyera në të bardhë me pjekje.

Për tarracën para aplikimit të shtresës termoizoluese duhen pastruar shtresat ekzistuese mbi të, dhe pas aplikimit të shtresës termoizoluese duhet bërë hidroizolimi i këtyre zonave. Duhet patur kujdes që hidroizolimi dhe termoizolimi i këtyre zonave të bëhen komfort standardeve.

Sipërfaqe vertikale që do të kapotohen janë 1500 m² ndërsa sipërfaqe tarrace ka 1200m²;

- b. Të hiqen, të përshtaten dhe rivendosen **tubat e shkarkimit të ujrave** të tarracës. Sepse sistemet e termoizolimit dhe hidroizolimit të tarracës kërkojnë heqjen e tubave të shkarkimit të tarracës dhe rivendosjen e tyre;

- c. Gjithashtu ndërhyrjet në fasadë do të kërkojnë: çmontimin dhe më pas ri montimin e sistemit të **rrufepritëseve**;
- d. Të korrigjohet defekti me **kuotën e trotuarit** kundrejt kuotës së dyshemesë faktike në katin përdhe të ndërtesës, në fasadën lindore, për të eliminuar rrezikun e depërtimit të ujërave të shiut në ndërtesë;
- e. Të ndërhyhet në elementet e **kasave të dritareve**, në mënyrë që të përshtaten me kanata të hapshme. Mbi zyrat e nivelit të tretë të hapësirës të parashikohet që të paktën në çdo 3 elemente dritaresh, njëra të jetë e hapshme me sistem të automatizuar, ose në të kundërt me sistem manual të komandueshëm nga niveli i lartësisë së punonjësve mbi nivelin e tretë. Gjithashtu në të dy fasadat lindore e perëndimore të ketë modifikime në kasat e dritareve të nivelit të tretë. Në çdo “figurë dritareje”, të paktën 3 nga elementet e xhamarive të modifikohen për tu pajisur me kanata të hapshme. Fig. 8. Këto kanata duhet të hapen nga jashtë me mentesha në pjesën e sipërme të xhamit me mekanizëm të automatizuar, pra me komandim elektronik. Skema e hapjes jepet në Fig. 9. Hapja nga jashtë me mekanizmat përkatës të fiksimit bën të mundur që kanata të mos ndikohet nga lëvizja e fortë e ajrit. Nëse bie shi, uji të mos depërtojë në mënyrë të menjëhershme brenda dhe lëvizja e rrymës së ajrit në brendësi të hapësirës, të diktuar nga rryma tërthore perëndim-lindje (e krijuar nga diferenca e presioneve të ajrit në dy fasadat), apo ajo diagonale (e krijuar nga diferenca e temperaturave dysheme-tavan), të mos jetë aq e fortë, sa të krijojë bezdi tek punonjësit në postet e punës.

Nëse gjatë porosisë për modifikimin e kasave të dritareve shihet si më e realizueshme montimi i kanatave me hapjen e automatizuar në formën e dritareve “sopraluce” me hapje nga brenda dhe nga lart, edhe kjo zgjidhje mbetet e pranueshme. Automatizimi i hapje-mbylljes është shumë i nevojshëm në këtë rast për shkak të funksionit të ndërtesës, sepse dritaret mund të harrohen apo mbeten hapur. Gjithashtu automatizimi eliminon rrezikun e hyrjes së ujit të shiut në brendësi gjatë shtrëngatave të papritura.



Fig. 8 Mundësi të ndërhyrjes në elementet e kasave të dritareve.




Fig. 9 Skema e hapjes së kanatës, por nga jashtë

Sistemi automatik në fjalë mund të integrohet me sensorë të temperaturës së brendshme të ajrit, nivelit të dioksidit të karbonit e me sensorë të shiut dhe të programohet në mënyrë të tillë që kanatat të hapen kur temperatura e brendshme dhe CO₂ kalojnë një kufi të caktuar dhe të mbyllen menjëherë sapo shiu fillon.

E njëjta mënyrë e hapjes rekomandohet edhe për dritaret “shed”. Pra nga jashtë-poshtë apo nga sipër-lart, sido që të realizohet më thjesht.

Ajrimi i tërthortë dhe ai diagonal, i komandueshëm lehtësisht nga përdoruesit e hapësirës mundëson ndërrimin e ajrit, dhe freskimin pasiv në periudhat transite të vitit, pranverë dhe vjeshtë. Në këto periudha kur temperaturat e ajrit të jashtëm, janë të afërta me temperaturat e komoditetit termik, sistemi HVAC mund të mbahet i fikur. Kjo gjithashtu do të kursejë energjinë e mundshme të konsumuar nga sistemi, të paktën në muajt: prill, maj, shtator, tetor. Madje kjo periudhë e mbajtjes fikur të sistemit mund të zgjatet nëse çarjet në ndërtesë komandohen siç duhet dhe kursimi i energjisë do të rritet. Energjia elektrike e fituar në këtë periudhë nga panelet fotovoltaike do të përdoret për sistemin e ndriçimit dhe pajisjet elektronike. Kështu ndërtesa ka mundësi të kthehet në auto eficiente.

Në bazë të teorisë së arritjes së komoditet termik pasiv në mjedisin e ndërtuar, rritja e shpejtësisë së lëvizjes së ajrit sjell ndjesinë e freskisë në lëkurë dhe trupi i njeriut mund të durojë temperatura më të larta se ato teorike të komfortit termik. Ndjesia në lëkurën e tij është sikur temperatura e mjedisit është më e ulët dhe e pranueshme. Këtë efekt e jep ventilimi, i propozuar edhe në këtë rast;

- f. Në fasadën lindore, davancalet e dritareve të katit përdhe duhet të dalin mbi kuotën e trotuarit në të paktën 15cm. Korigjimi i kuotës së trotuarit, do ta bëjë automatikisht këtë në fazën e zbatimit. Në të kundërt duhet ndërhyrë në kuotën e davancaleve dhe në riparimin e kasave të dritareve. E njëjta gjë vlen edhe për kuotat pragjeve të dyerve që hapen në fasadën lindore. Minimilashit duhet që pragjet të jenë 15 cm (1 këmbë-shkallë) mbi kuotën e trotuarit;
- g. Të merren gjithashtu masa për **korigjimin akustik**, sidomos të zyrave në nivelin e tretë. Gjatë vizitës në vend u hasën vështirësi në dëgjueshmëri dhe komunikim për shkak të efektit të shtuar të jehonës në hapësirë. Ky efekt duhet dhe mund të zbutet duke shtuar material zëabsorbues në kufizuesit anësorë dhe të sipërm të hapësirës. Kjo mund të arrihet edhe me aplikimin e materialeve të thjeshta (copa sfyngjeri, copa polisteroli poroz me dendësi më të vogël të mundshme të prerë me forma të ndryshme për të kënaqur çështje estetike të hapësirës dhe formën e dimensionet e vendit ku do të montohen, apo panele vibruese të realizuara nga marangozi, me karkasa druri e mbushje sfyngjeri apo pambuku mineral me dendësi të vogël), në formën e telajove të pikturave, të veshura me beze me dekor apo kanavacë e të piktura që ngjajnë si piktura, duke synuar mos cënimin e gjuhës arkitektonike të interiorit. Për çdo hapësirë me probleme të akustikës, duhet

bërë studim apo kqyrje e veçantë e problematikës sipas kushteve të hapësirës, para se të merren masa për korigjimin e kohës së reverberimit në to. Është lehtësisht e kuptueshme se hapësirat kanë nevojë për shtimin e zëabsorbimit pra për uljen e kohës së reverberimit. Në hapësirat me dimensione në plan e lartësi të madhe, duhet treguar kujdes i veçantë në pozicionin e montimit dhe llojin e materialit zëabsorbues;

- h. Fasada perëndimore** e ndërtesës Betahaus, ka **sipërfaqe të madhe xhami**. Më kushtet e klimës së Tiranës, dritare e orientuar nga perëndimi do të thotë: orë zgjatura me diellin përballë me dritaren në orët e pasdites. E përkthyer në terma energjetikë, do të thotë që në kushtet e periudhës së nxehtë të vitit në orët e pasdites kur temperaturat e ajrit janë maksimalet e ditës, dielli përballë me dritaren perëndimore, prodhon tejnxehje të hapësirës së kufizuar. Mjedisi i brendshëm fillon të marrë energji shtesë pasive prej rënies së rrezatimit direkt në dyshtemenë apo mobiljet në interior. Në bazë të teorisë së arritjes së komoditetit termik pasiv, minimalisht duhet penguar rrezatimi diellor direkt të bjerë në interiorin e hapësirës. Kështu duhet të parashikohet hijezimi i dritareve, por jo pengimi i dritës natyrore. Hijezuesat në këtë rast duhet ti qepen fasadës se jashtme. Projektimi i tyre duhet të bëhet me kushtin që hijezimi i plotë të fillojë në mesin e prillit për të mbaruar në ditët e para të muajit shtator.

Nëse buxheti nuk e lejon realizimin e tyre, apo nga projektimi elementet hijezues dalin të pa përputhshëm me fasadën, atëherë në konsultim me specialistet e prodhimit të xhamave, të shihet mundësia e shtimit të filtrave selektive low-e në xhamat ekzistues apo mini-grilave vertikale midis 2 fletëve të xhamave të komandueshme elektronikisht, apo automatikisht me sensorë të rrezatimit direkt diellor. Fig. 10

Nëse aplikohen filtrat (film-at), Fig. 11 (pra xhamat të kthehen në termikë) filtri duhet të jetë mbi 70 % selektiv për rrezatimin Ultraviolet;




Fig. 10 Shembull i grilave në mes të xhamave



Fig. 11 Shembull i filtrit (film)

Mini-grilat vertikale brenda xhamave, për sa kohë janë të ulura, pengojnë shikimin drejt eksterierit dhe njëkohësisht ulin nivelin e ndriçimit natyror në interior. Gjithashtu kërkojnë çmontimin dhe montimin e komplet xhamave, proces i cili kërkon më shumë kohë, më shumë impenjim dhe fasada mbetet pa xhamë për një periudhë të gjatë kohe.

Rekomandohet aplikimi i filmave selektivë “low-e”. Fig. 11;

- i.** Të parshikohen **2 mjedise zyrash** në katin përdhe. Pra të parashikohen panelet ndarëse të zyrave dhe mobilimi e pajisjet përkatëse;
- j.** Nëse ndërtesa një-katëshe në anën perëndimore të ndërtesës në fjalë nuk do të shtohet me një kat, atëherë është i detyrueshëm të paktën kqyrja në vend e problemeve të lagështirës në mure e tarracë, ndërprerja e burimit të lagështirës nëse ka dhe rinovimi i rifiniturave, për ti kthyer hapësirat në ambiente arkive për institucionin e FSHZH;
- k.** Të sitemohet dysHEMEJA e oborrit midis dy ndërtesave të sipërpërmendura dhe të realizohet gjelbërimi e mobilimi me stola sipas projektit fillestar;
- l.** Meqë të gjitha punimet e termoizolimit dhe të trajtimit akustik të hapësirave të kufizuara janë delikate, projekti i zbatimit i hartuar për to duhet të jetë i kontrolluar nga autoriteti kontraktor para dhe gjatë zbatimit të punimeve përkatëse.

4.3 Përtëritja/rehabilitimi i ndërtesës së arkivës

Për shkak të sistemimeve përreth ndërtesës dhe zonës së parkimit, ndërtesa ekzistuese njëkatëshe duhet të zvogëlohet dhe të bëhet në një linjë me ndërtesën kryesore. Në pjesën e mbetur të ndërtesës një katëshe do të kryhen ndërhyrje rehabilituese, të cilat përmbledhen në largimin suvatimeve, marrjen e masave hidroizoluese dhe termoizoluese dhe plotësimin me dyer e dritare dhe mobilim të brendshëm.

4.4 Sistemi HVAC

Projekti i HVAC në vija të përgjithshme është funksional, pra nuk ka situata të bllokuara apo të paqarta dhe është i realizueshëm.

Referuar projektit ekzistues me sipërfaqe totale rreth 2300m² dhe për kondicionimin e ndërtesës janë parashikuar mbi 330 kw ftohje (termik) nëpërmjet pajisjeve të brendshme dhe do të ventilohej dy mjediset e përbashkëta (Beta Arena dhe Event Box) me 20700m³/h ajër të përzier dhe për furnizimin me ajër të freskët të gjithë vëllimit tjetër me 11900m³/h. Për gjithë këtë sasi ajri ventilies do të duhet të shpenzohet një kapacitet ftohës prej 252kw ftohje (termik). Sipas këtyre rezultateve del që energjia specifike e çliruar në mjediset e brendshme është mbi 145 wat/m² (330kw/2300m² x 1000=145 wat/m²); këtij shpenzimi duhet ti shtohet edhe ngarkesa termike për ajrin ventilies (252kw termik).

Në një analizë të projektit ekzistues (duke pasur parasysh arkitekturën, strukturën dhe veprimtarinë që do të zhvillohet në ndërtesë dhe ndryshimet kundrejt atyre fillestare) kjo shifër është disi e lartë dhe mund të optimizohet më tej, optimizim i cili mund të arrihet duke kryer termoizolim të nevojshëm të ndërtesës dhe duke rishikuar edhe një herë projektin e kondicionimit. Që nga viti 2015 e deri në fund të vitit 2020 rrethanat, gjendja dhe kërkesat për një sistem kondicionimi kanë ndryshuar, si rrjedhojë ndryshojnë edhe përparësitë, të tilla si:

- Projektimi i një sistemi që të sigurojë komfort sa më të përsosur gjithmonë brenda kërkesave;
- Projektimi i një sistemi duke pasur parasysh dobishmëri sa më të lartë energjetike;
- përdorimi maksimal i kapaciteteve energjetike të çdo komponenti të sistemit të kondicionimit, duke eliminuar të gjitha shtesat e sigurisë së projektit apo të zbatuesit.
- Projektimi i një sistemi të tillë që të ketë një mirëmbajtje sa më të thjeshtë e sa më pak të kushtueshme, që të sigurojë një inspektim apo kontroll profilaktik sa më të thjeshtë;
- Projektimi i një sistemi që në përbërjen e tij të ketë sa më shumë komponentë të standardizuar dhe sa më pak komponentë të veçantë, vetëm për këtë zgjidhje.

Këto përparësi asnjëherë nuk humbasin vlerën e tyre e gjithmonë do të jenë në qendër të projektimit të mirëfilltë e të saktë. Por në zhvillimet e kohës disa parametra janë më në plan të parë e disa më të zbehtë; kështu në kohën e sotme (sidomos të theksuar nga pandemia COVID 19) ka mara përparësi projektimi i një sistemi kondicionimi **sa më fleksibel**, që tu përshtatet edhe **kërkesave të higjienës e sigurisë** në çdo moment e në çdo situatë. Kjo është një nga kërkesat kryesore gjatë hartimit të projektit zbatimit dhe instalimit të kondicionimit në këtë vepër.

Gjatë përmirësimit/plotësimit të projektit ekzistues të mbahet parasysh që sistemi i ventilimit të trajtojë jo vetëm kërkesat e komfortit por edhe të sigurisë dhe cilësisë së jetës sepse duhet ti bëjë mjediset e brendshme sa më të ngjashme me ato të jashtme.

Nga dokumentet ekzistuese të projektit HVAC vërehet se janë marrë parasysh mure të jashtme me suvatim nga të dy anët (jashtë e brenda), gjë e cila nuk është realizuar. Në këtë rast kapacitetet e pajisjeve të sistemit janë 5-7% më të vogla se sa duhen. Duke vendosur një sistem kapot (suatim termik) në mënyrën e duhur në muret e jashtme atëherë kapacitetet e pajisjeve të sistemit do të nevojiten më të vogla se sa janë dhënë në projektin ekzistues.

Në llogaritjet e projektit të HVAC është marrë parasysh një termoizolim tarrace horizontale me polisterol 10cm të trashë. Nëse ky termoizolim nuk është realizuar apo është realizuar pjesor, atëherë duhet të rriten kapacitetet e gjithë sistemit të kondicionimit ose të realizohet termoizolimi i duhur dhe i bashkërenduar me termoizolimin e mureve të fasadës.

Si përmbledhje e sa më sipër dhe në vijim të gjetjeve të tjera të këtij raporti teknik, theksojmë se projekti ekzistues i HVAC duhet të ripunohet në drejtim të:

- Sigurimit të një fleksibiliteti maksimal që mjediset të ndryshme të mund të përdoren për veprimtari të ndryshme sipas programeve që investitori do të ketë në të ardhmen duke rritur së tepërmi efektivitetin e shpenzimeve të bëra për rikonstruksionin e përgjithshëm të kësaj vepre (me fleksibilitet kuptohet p.sh. që një mjedis që zakonisht do të përdoret për zyra pune, në njëçast duhet të kthehet për të realizuar një veprimtari tjetër si p.sh. ekspozite, të mos kërkojë dhe ndërhyrjen në sistemin e kondicionimit. Sistemi i kondicionimit duhet të punojë normalisht edhe për këtë rast). Po kështu edhe optimizimi i energjisë në ato mjediset, përdorimi i të cilave është plotësisht i paracaktuar;

- Rillogaritjes së kapaciteve termike të çdo mjedisi të brendshëm duke marrë parasysh ndryshimet që duhet të realizohen nga ana arkitektonike (p.sh. suvatimi termik-kapota);
- Ripunimit të sistemit të ventilimit për ta bërë ndërtesën një mjedis sa më të sigurt edhe sipas rekomandimeve të OBSH;
- Përdorimit të pajisjeve standarde të kondicionimit me kosto sa më të ulët e që në bashkëpunim me Arkitektin të kihen parasysh karakteristikat e përgjithshme dhe të posaçme të veprave tip “Beta HAUSE”;
- Projektimit të një sistemi me mirëmbajtje minimale e me kosto të ulët.

Analiza e projektit ekzistues, gjendja faktike e ndërtesës së rikonstruktuar, ndryshimet në kërkesa në këtë periudhë 5 vjeçare dhe ato të bëra gjatë fillimit të vënies së saj në përdorim si dhe ndryshimet e propozuara në zërat e tjerë të raportit teknik, çojnë në domosdoshmërinë e rishikimit të projektit. Në zërat e preventivit që i përkasin projektit HVAC janë marrë parasysh edhe ndryshimet e sipërpërmendura. Mbetet që pas hartimit të projekt-zbatimit, të verifikohet përputhshmëria e tij me gjetjet dhe këshillimet e paraqitura më sipër.

4.5 Sistemet elektrike

Nga paraqitja e tyre nuk shihen mangësi vizuale. Skemat e paraqitura në projekt mund të shërbejnë për përfundimin e zbatimit të projektit. Në skemat e paneleve elektrik nuk vihet re si do të realizohet lidhja me energji elektrike e paneleve fotovoltaike. Kjo pikë duhet të sqarohet në projekt-zbatimin elektrik të fazës 2. Në skemën e panelit elektrik kryesor nuk është paraqitur qartë nëse gjeneratori elektrik do të hyjë në punë automatikisht apo manualisht. Gjithashtu gjeneratori nuk është parashikuar në fazën e parë. Bazuar në të dhënat e projektit është i nevojshëm një gjenerator elektrik diesel 330kVA, me panel automatik dhe i mbuluar, i cili duhet të vendoset në mjediset e jashtme. Nëse kërkesat e sistemit të kondicionimit do të ndryshojnë, atëherë gjatë projekt-zbatimit duhet mbajtur parasysh edhe ky ndryshim.

4.6 Ashensori

Struktura e kafazit të ashensorit, makineritë dhe dhomat teknike përkatëse duhet të jetë në përputhje me rregulloret kombëtare të fushës së ndërtimit dhe të jetë në gjendje të mbajë ngarkesën e specifikuar nga investitori. Kjo ngarkesë do të përcaktohet përpara hartimit të projektzbatimit të ndërhyrjeve në ndërtesë. Paraprakisht ashensori është parashikuar për 6 vetë, ku duhen mbajtur parasysh personat me aftësi ndryshe.

Toleranca maks. e lejuar për përmasat e kafazit dhe saktësinë e pajisjeve hidraulike janë +/- 25 mm.

Nivelet përfundimtare të dyshemesë duhet të bashkërendohet dhe shënohen qartë para fillimit të instalimit të ashensorit. Përpara projektimit të ashensorit të bëhet vizitë në terren dhe të saktësohen përmasat e gropës/kafazit dhe nëse është e nevojshme të bëhen ndryshimet e duhura në zonën e lënë enkas për ashensorin. Hapjet e ashensorit duhet të mbrohen në përputhje me rregulloret për të parandaluar rënien e njerëzve aksidentalisht.

Kushtet e përgjithshme të ndërtimit të ashensorit duhet të jenë në përputhje me EN 81-20/50. Kafazi i ashensorit, makineritë dhe dhomat teknike përkatëse nuk duhet të përdoren për qëllime të tjera përveç funksionit parësor të tij. Ato nuk duhet të përmbajnë fije, kablllo apo pajisje/elemente të tjera përveç se ato të nevojshmet për ashensorët. Dyshemeja e ashensorit duhet të jetë në nivel në çdo ndalesë. Nëse hapësira të arritshme ekzistojnë poshtë kafazit, baza e gropës duhet të projektohet për një ngarkesë të ushtruar të paktën 50 kN / m², dhe pesha e kundërt ose barazpesha duhet të pajisen me element sigurie.

Ventilimi duhet të jetë i tillë që motorët, pajisjet, kabllot elektrike, etj. të mbrohen nga pluhuri, avujt e dëmshëm dhe lagështia. Pusi duhet të pajiset me ndriçim elektrik të instaluar përgjithmonë, duke dhënë intensitetin e duhur të ndriçimit, edhe kur të gjitha dyert janë të mbyllura, në çdo pozicion të kabinës gjatë gjithë lëvizjes së tij në kafaz. Elementet e ndriçimit duhet të mbrohen nga dëmtimet mekanike.

Zhurma e gjeneruar nga ashensori kërkohet të jetë 62dbA (Leq), 65dbA (impuls). Pjesa e sipërme e kafazit duhet të projektohet dhe ndërtohet e tillë që të siguroj përmbushjen e rregullave kombëtare të zhurmës.

Kabina e kontrollit duhet të jetë e vendosur në një zonë të mbrojtur nga kushtet e motit si shiu, era dhe temperaturat nën + 5°C dhe mbi + 40°C. Duhet të sigurohet të paktën 200 lux intensitet të ndriçimit përpara kabinës së kontrollit. Kabina e kontrollit nuk duhet të jetë lehtësisht e arritshme nga përdoruesit e ashensorit dhe të ndërtesës pasi çon në situata të rrezikshme.

5. Sistemitet përreth ndërtesës dhe zona e parkimit

Sistemimi i oborrit rreth ndërtesës mbetet një nga zërat e parealizuar.

Parashikohet asfaltimi i rrugës nga hyrja në oborrin e pasëm të ISTN-së në drejtim të vijës së kalimit përballë me fasadën lindore të BetaHaus. Në hyrjen e oborrit gjithashtu do të vendoset pika e kontrollit dhe e pagesës së parkimit publik, të parashikuar në oborrin verior të Betahaus. Ndërkohë midis ISTN dhe Betahaus mbetet zonë parkimi për institucionet. E gjithë dyshemeja e parkimeve propozohet dhe parashikohet të shtrohet me pllaka betoni të parafabrikuara me boshllëqe, të mbushura me dhe' për të mundësuar gjelbërimin. Dekurajohet këtu përdorimi i asfaltit në masë, për arsye mjedisore. Pra për të ulur efektin e çlirimit të avujve të dëmshëm nga nxehja e asfaltit, dhe njëkohësisht për të ulur efektin e tejnxehjes të ajrit për shkak të nxehjes së asfaltit. Gjithashtu efekti viziv mbi gjelbërimin sado pak qoftë ai në boshllëqet, midis pllakave të betonit, është në të gjitha rastet më pozitiv se sa efekti viziv mbi asfalt. Boshllëqet e pllakave të betonit lejojnë filtrimin e ujit edhe tokën të marrë ujë ujin e shiut, aty ku ai bie. Sistemi i largimit të ujrave të bardha në këtë zonë do të jetë minimal.

Gjithashtu nevojitet si domosdoshmëri sistemimi i kuotës së trotuarit ekzistues para fasadës lindore të Betahaus. Kjo të bëhet në përputhje dhe para shtrimit të rrugës me asfalt, në mënyrë që kuota ekzistuese e dyshemesë së katit përdhe të BetaHaus të dalë minimalisht 15 cm mbi kuotën e trotuarit të vet dhe njëkohësisht, të respektohen standardet e kuotave midis trotuareve dhe rrugëve.

Gjithashtu oborri perëndimor duhet rifreskuar në shtresa. Duhet të rivlerësohet në vend materiali i shtresës ekzistuese të tij dhe të shikohet mundësia në zbatim e rifreskimit të

shtresës. E njëjta gjë vlen edhe për oborrin jugor. Referencë janë vizatimet bashkëngjitur këtij raporti.

Rrethimi i objektit gjithashtu duhet kqyrur, rifreskuar dhe zëvendësuar aty ku mungon. Në kufi me fushat e sportit të kompleksit Dajti dhe me rrugën “M. Gjollësja” rrethimi prashikohet me mur betoni deri në lartësinë 50 cm , dhe vazhdimi me kangjella deri në lartësinë 1.9m.

Nga një vend parkimi për motora dhe biçikleta janë parashikuar. Vizatimet shoqëruese japin detaje të shtresave dhe materialeve për sistemimin e oborrit.

6. Hapat për hartimin e projekt-zbatimit dhe kryerjen e punimeve

Kompania e cila do të marrë përsipër kryerjen e punimeve duhet të hartojë paraprakisht projekt-zbatimin e zërave të mbetur nga projekti fillestar dhe përmirësimeve të kërkuara në këtë raport teknik plotësues (së bashku me projekt-idenë e sistemimeve/parkimit dhe preventivin paraprak) të paraqitura këtu. Pas hartimit të projekt-zbatimit dhe preventivit përfundimtar përkatës, kompania zbatuese duhet të marrë miratimin nga autoriteti kontraktor përpara se të fillojë vënien në zbatim të projektit. Miratimi do të jepet pasi të verifikohet përmbushja e kërkesave të investitorit të dhëna paraprakisht në projektin ekzistues, në këtë raportin teknik dhe gjetjeve/plotësimeve përmirësuese që mund të vijnë gjatë procesit të hartimit të projekt-zbatimit.

7. Përvoja e zbatuesit

Për zërat që kërkohen për këtë ndërtim, në veçanti për impjanatin dhe instalimet HVAC të tij, kompania fituese, vetë ose përmes nën kontraktorëve të para deklaruar, duhet të ketë kryer punë të paktën të njëjta për nga natyra (vëllime të hapura), shkalla e vështirësisë dhe vlera e investimit.

RELACION TEKNIK ELEKTRIK

REHABILITIMI I ISTN (INSTITUTI I STUDIMEVE TEKNOLOGJIKE TE NDERTIMIT-TIRANE

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E.0610/3



2017

- Hyrje

Projektet elektrike do te realizohen ne perputhje me te gjitha normat dhe standartet e projektimit ne objekte te vecanta. Projektet do te garantojne sigurine, cilesine dhe stabilitetin me te larte ne furnizimin e objektit me energji elektrike. Keshtu, ne perputhje me zgjidhjen arkitektonike eshte bere nje kombinim i te gjitha hapesirave te nevojshme ne rregull qe te realizojme impiantin inxhinierik elektrik. Sistemet elektrike do te mbulojne te gjitha nevojat e kerkuara per objektin por gjithashtu do te llogariten rezervat e nevojshme per te rritur garancine dhe stabilitetin e sistemit dhe gjithashtu ne rast te nje sherbimi shtese ne te ardhmen.

- Nje pershkrim i shkurter i sistemeve elektrike qe perfshihen ne kete projekt eshte bere me poshte:

Furnizimi me energji elektrike do te realizohet me disa metoda te pavarura:

1. Rrjeti normal i cili furnizohet nga operatori vendas OSHE (kompani vendase e shperndarjes se energjise) ne vend.
2. Moto-gjeneratori silencioz i vendosur i cila do te llogaritet per konsumatore te vecante ne perputhje me kerkesat .
- Gjeneratorii zgjedhur do te jete ne perputhje me llogaritjet e konsumatoreve dhe kategorine qe do te kerkoje kete sherbim.
- Gjeneratori do te jete silencoze, deri ne 65 db, montuar ne zonen e pershtatshme ne ambjentin teknik.
3. UPS, i cilieshte i dedikuar per konsumatorin e preferuar dhe konsumatorin shume te sigurte, nga te cilet furnizimi me energji do te jete nga UPS te pavarur per sistemet e sigurise. Ndarja e ketyre konsumatoreve do te behet nga nevojat, kerkesat dhe ne perputhje me perfituesit gjate projektit.
- UPS e zgjedhur do te prodhohen me standartet e kerkuara per sherbimet me konsiderate te vecante, duke garantuar cilesi te larte, siguri per furnizimin e qarqeve te ndryshme te cilat do te ndahen ne baze te kerkesave te perfituesve. Do te llogaritet per autonomi jo me pak se 10 min si dhe furnizimi do te sigurohet nga gjeneratoret.

Furnizimi me energji elektrike do te behet te behet nga kabina elektrike me e afert.

- Fuqia e instalimeve elektrike (Fuqia, Ndricimi)	100 kw
- Fuqia e paisjeve mekanike	200 kw
- Fuqia e UPS	60 kw

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E.0610/3

Koeficienti i njekohshmerise se ngarkeses = 0.7

Fuqia e kerkuar per gjithe objektin do te jete:

$$P_{\text{kerkuar}} = 0.7 (100\text{kW} + 200\text{kW} + 60\text{kW})$$

$$P_{\text{kerkuar}} = 0.7 \times 360 = 252 \text{ kW}$$

$$\text{Fuqia e Plote} = S = P_{\text{kerkur}} / \cos \phi = 252 / 0.94 \approx 268 \text{ kva}$$

Fuqia totale e instaluar per te gjithe objektet eshte : ***Pins = 360 Kw dhe Fuqi e kerkuar eshte: Pkerk = 252 Kw.***

Piku I ngarkeses, per kete lloj konsumatori arrihet ne oret 16 – 22, kryesisht per periudhen e veres. Periudha e pik-ut perafrohet, kur ora astronomike ndryshon ne pranvere dhe ne vjeshte (-1/+1 ore)

Fuqia e elektromotorit me te madh eshte 7.5 kw per ashensorin.

Ngarkesa elektrike ne objektet e ndryshme eshte shperndare ne menyre simetrike ne te 3 fazat, duke u realizuar ne te gjithe panelet e mbrijtjes perkatese. Ngarkesa eshte e limituar me automat magneto-termik te vendosur ne panelin kryesor te tensionit te ulet ne kabine. Kjo ngarkese (rryme e limitatorit), percaktohet ne kontraten tip te Entit furnizues me energji elektrike)

Ne te gjitha llogaritjet si dhe ne percaktimin e seksioneve percjellesave, plotesohet kushti qe,devijimet e tensionit deri tek konsumatori I fundit nuk kalojne vleren:

$U\% < 2-4\%$ (llogaritjet jane bere qe nga BTU deri tek perdoruesi I fundit)

Zgjedhja e te gjitha pajisjeve kumutuese ne kuadrot qe ndodhen ne distance mbi 60 ml nga kuadri i T.U. i kabines elektrike duhet te plotesoje kushtin qe aftesine shkeputese nga rrymat e lidhjes se shkurter 1 ose 3 fazore; $I_{cc}(lej)=6\text{kA}$, kurse per distance $L>60\text{ml}$, $I_{cc}=4.5\text{kA}$.

I. Shperndarjane tension te ulet

Shperndarja ne tension te ulet fillon nga Paneli i Pergjithshem i Shperndarjes ne kabinen elektrike, deri ne instalimin e tensionit te ulet per çdo prize, celes dhe drite. Shperndarja e tensionit te ulet do te pergatitet me ane te shinave ose kablllove, te cilat jane pershkruar me poshte:

Paneli i pergjithshem i tensionit te ulet

Paneli kryesor i tensionit te ulet do te vendoset ne dhomen teknike, te furnizuara me tension te ulet nga paneli kryesor i godines.

ING. DESHIRA MENA

NR. LIT. E.0610/3

Paneli kryesor i tensionit te ulet do te jete metalik, i lyer, rezistent ndaj gerryerjes, dhe i mbyllur. Dimensionet e tij jane ne varesi te pajisjeve elektrike qe do te montohen qe jane ne varesi te ngarkeses elektrike te objektit.

Paneli kryesor i tensionit te ulet duhet te permbaje te pakten:

- Automati kryesor me 4 faza 400V, me amperazh ne varesi nga ngarkesa
- Automat me tre faza per çdo kat (sugjerojme qe çdo kat te pajiset me linje tre fazore per nje shperndarje me te mire te sigurse te ngarkeses)
- Sinjale te fazave te treguara ne kopertinen e saj
- Morseta e tokezimit e lidhur me sistemin e tokezimit

Montohet se bashku me komponentet, duhet te behet nga nje specialist elektrik nen mbikeqyrjen e inxhinierit. Te gjitha lidhjen e percjellesave dhe kablllove brenda panelit do te behet me ane te kapikordave te vecanta per secilin tip seksioni dhe me nastro dhe ngjitese.

Paneli metalik duhet te jete i lidhur me sistemin e tokezimit.

Nje shembull i panelit kryesor i tensionit te ulet eshte specifikuar si me poshte:

- Montimi ne siperfaqe (te prodhuara ne pelhure nga fletet)
- pelhure te prodhuara me flete çeliku e pjekur ne furre
- Permasat: sipas projektimit

Min. Temperaturave te instalimit -25 ° C Max.

Temperaturat instalimi 60 ° C IK Code 07 Test i ngrohjes teli 750 ° C

Kutite celesave te automateve

Kutite celesave te automateve jane panelet elektrike per zonen e veçante, e njejte me panele kat, me nje ndryshim se numri i paneleve eshte reduktuar. Keto kuti do te perdoren ne zonate ndryshme.

Montimi i kutive ne suva do te behet me ane te vidave me mbajttese, ndersa keto nen suva do te jete fikse me llaç dhe nuk duhet te jete mbi nivelin e suvase.

Siguresat

Siguresat jane ndareset e qarkut, te cilat operojne ne menyre automatike ne rast te mbingarkeses dhe lidhjes se shkurter ne qark te hapur. Per kete perzgjedhjae Amperazhit te automateve duhet te behet duke marre parasysh mbrojtjen e ngarkeses.

Automatet e perdorur ne zona publike janemagneto-termik dhe me mbrojtje diferenciale.

Automatet jane njesi mbrojttese nga mbingarkesa. Ato vendosen ne kutite e automateve, ne panelet e kateve dhe ne panelin kryesor i tensionit te ulet.

Sipas numrit te fazes qe mbrojneata jane nje fazore dhe trefazor.

Sipas Amperazhit ato ndahen 6A: 10A; 20A, 25A, 32A, 40A, 50A, 63A, 100A

Sipas Amper ata jane te ndare 125A; 160A; 250A; 400A;

Sipas numrit te poleve automatet jane te ndare: dy polare dhe kater polare.

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E.061013


II. Infrastruktura e instalimit elektrik

a) Tela dhe Kabllot:

Te gjithë telat dhe kabllot duhet te kene certifikaten e miratimit nga autoritetet e miratimit dhe certifikatene e fabrikes. Do te realizohen me kablllo shume polare FG7-OR (3P+N) rezistent kundra djegies dhe emetimit te gazeve toksike.

Per qarqet e dritave te sigurise kabllot do te jene me izolim te dyfishte te tipit rezistent nga zjarri FTG-OM1.

Te gjithë kabllot do te verifikohen dhe llogariten sipas:

- qellimit te perdodrimit
- verifikimit te renies se tensionit
- verifikimit te nxehjes gjate lidhjeve te shkurtra

Tela duhet te jene perçues bakrite izoluar me PVC me berthame te vetme brenda perçuesit.

Telat e izoluar duhet te jete me ngjyre me teerret per te identifikuar faze dhe neutrin.

Te gjitha rastet kur kabllot PVC perfundoje ne nje bord te shperndarjes se siguresave, pajisjet elektrike, etj duhet te lihen te lira nje sasi te lejuar per te nxjerre me vone ne rast se duhet pa shkaktuar terheqjen e tyre.

Numri i kablllove i instaluar netuba ose kanalina duhet te jene te tilla qe te mundesojne etiketimit te lehte pa demtuar kabllot dhe kurre nuk duhet te jete me shume se 40%. Izolimi PVC i kablllove dhe telave te shumefishte ose me tel te vetem duhet te jene te afte qe te rezistojederi 600/1000V.

Te gjithë kabllot e vene brenda tubave duhet te izolohe me perçueshmeri te larte PVC.

Kabllot fleksibel te perbehen nga tela me shume shirita dhe ne varesi te asaj qe ne kemi:

- Kabell me tre tela, 1 neutri, 1 toka (per sistemin mono faze)
- Kabell me kater tela, 3 faze dhe 1 neutri (per sistemin e trefaze, pa toke)
- Kabell me pese tela, 3 faza dhe 1 neutridhe 1 toka (per sistemin e trefaze, metoke)

b) Kanalinat dhe aksesoret

Instalimielektrik mund te behet ne dy menyra :

